Për ekranet informative dhe ndërfaqet interaktive duhet të hartohen template UI në përputhje me identitetin vizual dhe në koherencë me sinjalistikën fizike.

Shënim:

Të gjithë elementët e sinjalistikës duhet të shoqërohen me udhëzime të qarta në lidhje me formën, materialin, ngjyrat, përmasat, tipografinë, përmbajtjen tekstuale, teknikën e realizimit. Të gjitha këto informacione duhet të përfshihen në një manual në lidhje me sinjalistikën, pjesë ky i manualit final të Identitetit vizual (pika 4.10).

1.1.8.11 Elementët e sinjalistikës duhet të dizajnohen në bazë të projektit të ndërtesës së re ku përfshihen ambientet:

Sipërfaqe totale: 9,040 m²

— 2,300 m² nëntokë

— 6,740 m² mbi tokë

Struktura kryesore funksionale

- 11 salla ekspozimi – 3,700 m²
- 2 laboratorë restaurim-konservimi – 220 m²
- 1 sallë edukimi – 130 m²
- Bibliotekë – 75 m²
- Dyqan / librari – 230 m²
- Magazinë (fondi) me klimë të kontrolluar – 1,240 m²
- Administratë dhe staf – 555 m²
- Holli i hyrjes – 270 m²
- Bar / kafene – 240 m²
- Auditorium – 195 m²
- Terracë publike – 580 m²

Shënim:

Projekti i detajuar i ndërtesës së re të GKA do i dorëzohet Operatorit Ekonomik në format pdf pas lidhjes së kontratës.

Operatori ekonomik duhet të konsultohet me Autoritetin kontraktor në çdo fazë të realizimit të paketës së sinjalistikës.

1.1.9 Dizajn i Produkteve promociionale

Dizajnim i 4 produkteve bazuar në identitetin e ri si p.sh:

- T-shirt
- Mbajtëse Çelësash
- Çantë
- Bllok Shënimesh.

1.1.10 Dizajnim i Manuali i identitetit vizual

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një manual të plotë të përdorimit të identitetit vizual që përfshin rregullat e përdorimit të elementeve grafike dhe template-t përkatëse.

Dokumenti final duhet të përfshijë:

- Rregulla tipografike
- Rregulla përdorimi logo
- Parime aplikimi digjital & analog
- Template (Shembuj)
- Rregulla të tjera të përdorimit të komunikimi vizual;
- Open files (File të hapura dhe të përpunueshme) për përdorim nga stafi

1.1.11 Dizajn i Webfaqes & UX – User Experience (Përvoja e Përdoruesit) / UI – User Interface (Ndërfaqja Vizuale)

- Dizajnim grafik dygjuhësh
- Arkitektura e websitit - harta strukturore dhe skeleti i faqes web
- Dizajn për Desktop dhe Mobile
- Harta e Faqes përfshin:
 - Kryefaqja: Ekspozita Aktuale; Lajme / Evente; Koleksioni
 - Vizito: Planifiko vizitën; Orari & biletat; Si të arrini (transport & hartë); shërbimet
 - Koleksioni: Linja muzeale (prezantimi i përhershëm); Koleksioni sipas periudhave; Galeri me 200 + Imazhe me foto dhe tekst
 - Ekspozita: Ekspozita aktuale; Ekspozita të ardhshme; Ekspozita të kaluara (arkiv)
 - Evente: Kalendari i eventeve; Workshope / edukim; Biseda & ligjërata; Performanca; Evente speciale; Kinemaja
 - Rreth nesh: Misioni & vizioni; Historia e institucionit; Partnerë & rrjete; Politika institucionale
 - Botime: Katalogë ekspozitash: Publikime kërkimore; Katalog; Shkarkime (PDF); Libraria e GKA
 - Programi i Transparencës: mundësi për të aksesuar Kontakt (Home, Visit, Collections, Exhibition, Events, About, Press, Transparency Program, Contact).

1.1.12 Trajnim dhe konsulencë

1.1.12.1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë trajnim të strukturuar për stafin e Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim sigurimin e zbatimit korrekt dhe të qëndrueshëm të identitetit vizual në të gjitha format e komunikimit.

Trajnimi duhet të përfshijë:

- përdorimin e manualit të identitetit vizual
- aplikimin e elementeve grafike në materiale digjitale dhe analoge
- përdorimin e template-ve dhe file-ve të hapura
- udhëzime praktike për prodhimin e materialeve të komunikimit

1.1.12.2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbim konsulence pa kosto shtesë për të paktën 3 (tre) aktivitete (ekspozita) pas përfundimit të kontratës, me qëllim mbështetjen e zbatimit të identitetit vizual në praktikë.

4.3 SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN 1

1.3.1 Kërkesat minimale funksionale

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë një shërbim që:

- garantojnë koherencë vizuale në të gjitha materialet e institucionit;
- të jenë të përdorshme nga stafi i institucionit pas përfundimit të kontratës;

-
- të jenë të aplikueshme në dy gjuhë;
 - të jenë të përshtatshme për një institucion kulturor publik dhe sipas standarteve Europiane të Institucioneve të ngjashme

1.3.2 Kërkesa për Branding & Identitet Vizual

1.3.2.1 Logo dhe Dizajn Korporativ

- Zhvillimi i një logoje vektoriale dhe variacione të saj të shkallëzueshme (formatet SVG, AI, EPS).
- Versione të optimizuara për përdorim digjital dhe në print.
- Koncept tipografik shumëgjuhësh.

Përdorshmëri në:

- Media të printuara
- Platforma digjitale
- Motion graphics (grafika të levizeshme)
- Sinjalistikë arkitekturore

Specifikimet e ngjyrave duhet të përfshijnë:

- CMYK
- RGB
- HEX

Tipografi të përzgjedhur për GKA, opsionale mundësia për të dizajnuar dhe prodhuar një Tipografi të veçantë për GKA.

Tipografia/fonti duhet të dorëzohet, nëse është e mundur, në formatet e mëposhtme:

- OTF
- TTF
- WOFF / WOFF2

Cdo lloj Tipografia/Fonti tjetër i përdorur duhet të dorëzohet në formatet:

- OTF
- TTF
- WOFF / WOFF2

Fontet e përzgjedhura për identitetin duhet të jenë të licencuara zyrtarisht dhe të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktues së bashku me një licencë përdorimi të përhershme. Kostoja e licencave përfshihet në ofertë.

Ose duhet të jenë fonte të krijuara veçanerisht për këtë projekt, dhe ti dorëzohen kontraktorit me një certifikim dhe të drejtë përdorimi pa limit.

Duhet të mbështesë gjuhët me alfabet latin, përfshirë të paktën anglisht dhe shqip, me set të plotë karakteresh dhe diakritikësh.

1.3.2.2 Sistemi i Dizajnit duhet të jetë:

- Sistem dizajni modular dhe i shkallëzueshëm.
- Sistem i përcaktuar i grid-it.
- Parime të layout-it responsive.
- Bibliotekë ikonash vektoriale.
- Udhëzime të qarta për trajtimin e imazheve.

1.3.3 Kërkesa për Dizajnin e Materialeve të Printueshme

- Skedarë të gatshëm për print në përputhje me standardin PDF/X.
- Menaxhim ngjyrash sipas standardeve përkatëse.
- Standarde profesionale tipografike duke përdorur veçoritë OpenType.
- Vendosje korrekte e tekstit në dy gjuhë dhe ndarje e saktë e fjalëve.

1.3.3.1 Dizajnim i Katalogut të Ekspozitave

- Dizajnim dhe Konceptim grafik (layout, tipografi, ngjyra, materialitet) 200 dhe 400 faqe
- Faqosje dhe përgatitje tipografike në dy gjuhë (AL/EN)
- Përfshirja e 300 imazheve
- Përfshirja e teksteve max 316,000 karaktere
- Sisteme layout-i të strukturuar për përmbajtje të gjata.
- Sisteme për titra dhe indeksim.
- Flukse pune për menaxhimin e imazheve.
- Skedarë prepress të gatshëm për shtypshkronjë.

1.3.3.2 Dizajnimi i Posterave dhe Banerave

- Dizajnim dhe Konceptim grafik (layout, tipografi, ngjyra, materialitet) 6 variante Seri Posterash në përmasa të ndryshme të shkallëzueshme (3 ekspozitat e pëkohëshme + 3 Ekspozitat e Koleksionit)
- Dizajnim dhe Konceptim grafik (layout, tipografi, ngjyra, materialitet) 6 variante Banerash në përmasa të ndryshme të shkallëzueshme (3 ekspozitat e pëkohëshme + 3 Ekspozitat e Koleksionit)

1.3.4 Dizajni për Komunikim Digjital

Modele dizajni për rrjetet sociale për:

- Instagram (feed, stories, carousel)
- Facebook (event, cover, profile)
- Formate të editueshme për përdorim nga stafi i brendshëm.
- Përputhshmëri me Adobe InDesign.
- Model për newsletter të përputhshëm me Mailchimp.

1.3.5 Sinjalistikë & Wayfinding

- Standarde lexueshmërie bazuar në distancën e shikimit.

-
- Sinjalistikë në përputhje me standardet e aksesueshmërisë.
 - Standarde të përcaktuara tipografie dhe kontrasti.
 - Koherencë vizuale
 - Plane sinjalistike vektoriale të çdo salle dhe kateve.
 - Skedarë vektorialë të gatshëm për prodhim.
 - Skeda teknike me përmbajtje të detajuar në:
 - Përmasa
 - Materializim
 - Tipografi
 - Përmbajtje tekstuale
 - Metodë printimi ose gdhëndje
 - Ngjyra/karakteri kromatik
 - Ndriçim (nëse ka)
 - Standarde dhe metoda prodhimi

1.3.6 Dorëzimet dhe Standardet e Skedarëve

- Organizim i strukturuar i të gjithë dorëzimeve të materialit në foldera
- Sistem i standardizuar i emërimit të materialit të dorëzuar
- Dokumentacion i plotë i manualit të dizajnit/ udhëzues stili

Dorëzimi i skedarëve të hapur të punës duhet të jenë të aksesueshme nëpërmjet programeve të mëposhteme:

- Adobe InDesign
- Illustrator
- Photoshop
- Figma

Formatet e eksportit:

- PDF/X
- SVG
- PNG
- JPG
- MP4/MOV
- OTF/TTF, WOFF/WOFF2
- CAD/DWG (për materialet e sinjalistikës që përputhen me planet arkitektonike të ndërtesës)

1.3.7 Dokumentacion dhe Trajnim

- Dorëzim i Style Guide (manual i stilit të dizajnit) i plotë.
- Manual Dizajni që përfshin skenarë përdorimi.
- Orë trajnimi për përdorimin e dizajnit për stafin

1.3.8 Sigurimi i Cilësisë dhe Testimi

- Testim në shfletues të ndryshëm (cross-browser).
- Testim në pajisje të ndryshme.
- Testim i aksesueshmërisë.

- Procedura verifikimi para printimit.

1.3.9 Kërkesa për Ekzekutimin e Projektit

- Planifikim projekti i bazuar në faza
- Aprovim paraprakt nga autoriteti kontraktor për çdo material para dorëzimit
- Raportim i rregullt i progresit tek autoriteti kontraktor.
- Cikle të dokumentuara feedback-u dhe rishikimi.
- Kufij të përcaktuar rishikimesh për faqosjen e publikimit të katalogut të koleksionit me dy faza korigjimi të materialit të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor.

1.3.10 Kërkesa për Dorëzimin Përfundimtar

- Transferim i plotë i të gjitha produkteve dhe aseteve të dakordësuara.
- Arkivë e strukturuar e të gjithë skedarëve të projektit.

1.3.11 Kërkesa për dizajnim UX/UI për Website

- Qasje dizajni **mobile-first (prioritet dizajnit për telefona mobil)**
- Arkitekturë e plotë informacioni përfshirë sitemap.
- Prototip interaktiv ose **DEMO** para zhvillimit përfundimtar

Dizajn responsive për:

- Pajisje mobile
- Tableta
- Kompjuterë desktop
- Ekrane të mëdha

Struktura navigimi të qarta të përshtatura për publikun e muzeut:

- Ekspozita
- Koleksione
- Evente
- Informacion për vizitorët

1.4 PRODUKTET DHE DORËZIMET E PROJEKTIT PËR LOTIN 1

1.4.1 Identiteti Vizual Institucional

Operatori ekonomik duhet të realizojë dhe dorëzojë produktet e mëposhtme në kuadër të projektit që përfshin:

Produkti	Numri minimal i varianteve
Logo institucionale	1
Variacione të logos (horizontal, vertikal, monokrom)	minimum 6
Paleta zyrtare e ngjyrave	1 sistem (6 variacione)
Sistemi tipografik institucional	minimum 1 familje fontesh

Sistemi grafik i elementeve vizuale (Ikona)	minimum 10 elemente
---	---------------------

1.4.2 Materiale Institucionale për Printim

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë dizajnin për materialet institucionale të mëposhtme:

Produkti	Numri i varianteve
Letër me kokë institucionale	2
Zarfe institucionale	2
Kartëvizita	2
Badge	2
Vulë	1

1.4.3 Materiale Komunikimi dhe Promovimi

Operatori ekonomik duhet të realizojë dizajnin për materialet e komunikimit të institucionit.

Produkti	Numri minimal i varianteve
Poster për koleksionin	minimum 3
Poster për ekspozita të përkohshme	minimum 3
Baner për koleksionin	minimum 3
Baner për ekspozitat e përkohëshme	minimum 3
Poster eventesh edukuese, workshop, film programming, tours etj	minimum 3
Flyer	minimum 2(një për koleksionin dhe një për ekspozitat e përkohshme)
Broshura informuese	minimum 2 (deri 12 faqe/formati A5)
Ftesa(2 faqe)	minimum 4

1.4.4 Publikime editoriale

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë sistemin grafik për publikimet e institucionit:-

Produkti	Specifikimet
Katalog ekspozite koleksioni gati për shtyp	1 (me teks 316.000 karaktere, 300 imazhe dhe numër faqesh deri në 400+)
<i>Shënim: Katalogët i koleksionit duhet të kalojnë 2 cikle korrigjimi dhe vendsoje materiali ne dokument para se të dorëzohet gati për shtyp</i>	
Template katalogu ekspozite të përkohshme	1 (me tekst 50,000 karaktere, 60 imazhe dhe numër faqesh deri në 200+)

1.4.5 Materiale promocioni

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë aplikime grafike për produkte promocionale institucionale, në përputhje me identitetin e ri vizual. Operatori ekonomik duhet të paraqesë jo më pak se 4 (katër) tipologji produktesh promocionale, të cilat mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në produktet e mëposhtme:

Produkti	Numri minimal i varianteve
T-shirt	Minimumi 1 variante
Mbajtëse çelësash	Minimumi 1 variante
Çantë	Minimumi 1 variante
Bllok shënimesh	Minimumi 1 variante

1.4.6 Materiale komunikim digjital

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë template për komunikimin në rrjetet sociale.

Platforma	Variantet
Instagram post	minimum 6
Instagram stories	minimum 6
Instagram carousel	minimum 4
Facebook post	minimum 4
Facebook cover	minimum 4
Facebook event	minimum 4
Newsletter	1 template

1.4.7 Sistemi i Sinjalistikës dhe Wayfinding

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë sistemin e orientimit në hapësirat e muzeut.

Elementi	Sasia
Plan Sinjalistikë hyrëse jashtë ndërtese	1
Plan Sinjalistikë orientimi për hapësirat publike të brendshme brenda ndërtesës	1
Plan Sinjalistikë Informacioni për ekspozitat	1
	minimum 8
Planimetri e sallave të ekspozimit (10 sala)	1
Tekste Murale dygjuhësh	20
Etiketa	640
Plane sinjalistike vektoriale të çdo salle dhe sipas kateve.	1
Skedarë vektorialë ose CAD/DWG të gatshëm për prodhim për çdo material ne lidhje me sinjalistikën	1
Udhëzime për materiale dhe prodhim	1

1.4.8 Dizajni i Webfaqes Institucionale

Operatori ekonomik duhet të zhvillojë dizajn të webfaqes institucionale me strukturën minimale të mëposhtme:

Seksioni	Minimum faqesh
Faqja kryesore	1
Vizito	1
Ekspozita	1
Koleksione	1
Evente	1
Informacion për vizitorët	1
Arkiva (me një databazë prej 300 imazhesh)	1
Rreth nesh	1
Botime	1
Kontakt	1
Programi i transparencës	1

Website duhet të përfshijë gjithashtu:

- sistem kërkimi
- integrim të kalendarit të eventeve
- integrim të lidhjes me mediat sociale
- Interface dygjuhësh për përdoruesin (Shqip dhe Anglisht)

1.4.9 Dokumentacioni përfundimtar

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

Dokumenti	Specifikimi
Manual i identitetit vizual	1
Manual i aplikimit të dizajnit	1
Arkivë e plotë e skedarëve të projektit	1

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

LOTI 2

Objekti i Lotit 2: Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.

1. KOMPONENTËT E SHËRBIMIT PËR LOTIN 2

Dizajni i Webfaqes do të bazohet në udhëzimet e Lotit 1.

1.2 Zhvillimi i Webfaqes – Programim FRONTEND (pjesa e jashtme e faqes web)

- Programimi i plotë
- Responsive design (dizajn i përshtatshëm ndaj pajisjeve të ndryshme)
- Elemente interaktive
- Integrim grafikash dhe animacionesh
- Funksione bazë për aksesueshmëri

1.3 Zhvillimi I Websitit – Programim BACKEND (pjesa e brendshme e sistemit)

- CMS (Content Management System) Menaxhimi i sistemit të personalizuar
- Integrim frontend/backend

1.4 Data System / Database

Operatori ekonomik duhet të projektojë dhe zhvillojë një sistem të strukturuar të të dhënave (database), ose një CMS me skedarë statikë (pa bazë të dhënash), ose një CMS që përdor një bazë të dhënash SQL, në varësi të nevojave të infrastrukturës.

1.5 Trajnim dhe konsulencë

1.5.1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë trajnim të strukturuar për stafin e Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim përdorimin dhe menaxhimin e faqes web dhe platformave digjitale.

Trajnimi duhet të përfshijë:

- udhëzime për përdorimin dhe menaxhimin e faqes web dhe platformave digjitale

1.5.2. Operatori ekonomik do të ofrojë konsulencë, asistencë dhe mirëmbajtje të Webfaqes deri 6 muaj pas lançimit. Mirëmbajtja përfshin përditësime teknike, kontrolle sigurie dhe korrigjim gabimesh brenda një kufiri të arsyeshëm.

2 FAZAT E REALIZIMIT TË SHËRBIMIT PËR LOTIN 2

Faza I – Zhvillimi i platformës digjitale, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital

- Zhvillim I Platforma digjitale (Webfaqja)
- Trajnim dhe konsulencë për stafin e GKA

Kjo fazë përmbyllet me miratimin e materialeve, marrjen në dorëzim të skedarëve dhe trajnimin e stafit

Shënim: Zhvillimi i Lotit 2 do të nisë në momentin e dorëzimit të Fazës II të Lotit 1.

2.3 SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR LOTIN 2

2.3.1 Kërkesa Teknike për Zhvillimin e Website

2.3.1.1 Frontend & Përvoja e Përdoruesit

- Website modern dhe në përputhje me standardet duke përdorur të paktën HTML5, CSS3 dhe JavaScript.
- Dizajn responsive për desktop, tablet dhe pajisje mobile.
- Testim në versionet aktuale të Chrome, Safari dhe Firefox, etj.
- Faqe me ngarkim të shpejtë duke përdorur praktikatat moderne të optimizimit të performancës.
- Aksesueshmëri e krahasueshme me WCAG 2.1 Niveli AA për të gjitha template-t e dakordësuara;
- Navigim i aksesueshëm përmes tastierës dhe forma të aksesueshme.
- Strukturë teknike miqësore për motorët e kërkimit (URL të pastra, metadata, sitemap).
- Webfaqja duhet të jetë e testuar si në pjesën e kodit edhe në pjesën e funksionalitetit teknik, lexueshmërisë së kodit, dhe ka zbatim të menaxhimit të memories përmes strategjisë type-safe.
- Webfaqja duhet të dorëzohet përmes një platforme të ndërmjetme siç është Github në zotërimin e Galerisë Kombetare si dhe USB ose Cloud.

Shënim:

Hostimi dhe blerja e domainit behen nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.1.2 Sistemi i Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS) për Webfaqen

- Implementimi i një sistemi CMS të lehtë për përdorim (jo WordPress ose Wix).
- Ndërfaqe editoriale miqësore për staf jo teknik.
- Akses i bazuar në role (p.sh. administratorë, redaktorë, përkthyes).
- Menaxhim shumëgjuhësh i përmbajtjes me gjuhë bazë rezervë.
- Bibliotekë mediash me optimizim imazhesh dhe mbështetje për aksesueshmëri (alt text).
- Trajnim për CMS për stafin, përfshirë dokumentacionin.

2.3.1.3 Aksesueshmëria e Websitit

- Çdo imazh i një objekti muzeal duhet të ketë përshkrim alternativ të detajuar, që përfshin objektin, materialin, periudhën historike dhe kontekstin e tij.
- Videot dhe materialet audiovizuale duhet të përfshijnë titra, përshkrime audio dhe transkripte, në mënyrë që të jenë të kuptueshme për personat me dëmtime dëgjimi.
- Website-i duhet të sigurojë kontrast të mjaftueshëm ngjyrash dhe lexueshmëri të lartë të tekstit.
- Website-i duhet të jetë “user friendly”(I lehtë për përdoruesin).

2.3.1.4 Performanca, Siguria dhe Operimi

Website i dorëzuar përmes HTTPS.

- Optimizim për ngarkim të shpejtë të faqeve përmes caching dhe optimizimit të aseteve.
- Sistem i mirëmbajtshëm me mundësi përditësimi.
- Konfigurim i sigurt sipas standardeve të njohura të sigurisë në web.
- Backup-e automatike ditore me procedura të dokumentuara rikthimi.
- Mjedise të ndara staging dhe production (rekomandohet).

2.3.1.5 Siguria dhe Mbrojtja e të Dhënave

Website duhet të përfshijë mbrojtje ndaj rreziqeve të zakonshme të sigurisë në web, përfshirë:

- Cross-site scripting (XSS)
- Cross-site request forgery (CSRF)
- Akses i paautorizuar në ndërfaqen e administrimit
- Reziqe të tjera potenciale

2.3.1.6 Përputhshmëria me legjislacionin në fuqi

Ndërtimi dhe konfigurimi i Website duhet të përputhet me VKM Nr.782, datë 18.12.2024 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve të internetit të autoriteteve publike”*.

2.3.1.7 Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë

- Duhet të merret parasysh Standardi ndërkombëtar kryesor për aksesueshmërinë e web-it **WCAG**, i zhvilluar nga **W3C** (<https://www.w3.org/TR/WCAG21/>)
- Ky standard përdoret gjerësisht nga institucione publike, kulturore dhe arsimore për të siguruar përmbajtje digjitale të përdorshme për të gjithë.
- Versioni më i përdorur aktualisht është **WCAG 2.1**, ndërsa shumë institucione po kalojnë në **WCAG 2.2**.
- Udhëzimet bazohen në katër parime themelore: përmbajtja duhet të jetë **e perceptueshme, e operueshme, e kuptueshme dhe e qëndrueshme (POUR)**.
- Referencë <https://www.w3.org/TR/WCAG21/>

2.2.3 Dokumentacion dhe Trajnim

- Dorëzim i Style Guide (manual i stilit të dizajnit) i plotë.
- Manual Dizajni që përfshin skenarë përdorimi.
- Orë trajnimi për CMS për stafin.

2.2.4 Sigurimi i Cilësisë dhe Testimi

- Testim në shfletues të ndryshëm (cross-browser).
- Testim në pajisje të ndryshme.
- Testim i aksesueshmërisë.

2.2.5 Kërkesa për Ekzekutimin e Projektit

- Planifikim projekti i bazuar në faza
- Aprovim paraprakt nga autoriteti kontraktor për çdo material para dorëzimit
- Raportim i rregullt i progresit tek autoriteti kontraktor.
- Cikle të dokumentuara feedback-u dhe rishikimi.

2.2.6 Kërkesa për Dorëzimin Përfundimtar

- Transferim i plotë i të gjitha produkteve dhe aseteve të dakordësuara.
- Arkivë e strukturuar e të gjithë skedarëve të projektit.

5.4 PRODUKTET DHE DORËZIMET E PROJEKTIT PËR LOTIN 2

5.4.1 Dokumentacioni përfundimtar

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kod burimor dhe dokumentacion teknik i dorëzimit

Dokumentacion për përdorimin dhe administrimin e CMS

Manual përdorimi për stafin

Arkivë e strukturuar e skedarëve të projektit për Lotin 2

Dokumenti	Specifikimi
Manual i përdorimit të CMS	1
Arkivë e plotë e skedarëve të projektit	1
Kod burimor dhe dokumentacion teknik i dorëzimit	1
Dokumentacion për përdorimin dhe administrimin e CMS	1

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Për Lotin 1: Konceptimi dhe dizajnimi i identitetit vizual, dizajnit të websitit, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial dhe sinjalistikës/wayfinding për Galerinë Kombëtare të Arteve.

Shërbimi duhet të realizohet brenda afatit prej **4 (katër) muajsh**, sipas fazave të përmendura në kapitullin 5.

Pas miratimit të marrë nga autoriteti kontraktor për aprovim të koncepteve, për çdo fazë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë produktet përkatëse sipas planit të punës dhe grafikut të realizimit, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Pagesa do të kryhet në mënyrë të pjesshme, sipas fazave të përfundimit dhe pas miratimit të dorëzimeve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor.

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI	KOHËZGJATJA E DETYRËS	Planifikimi i pagesave
Loti 1: Konceptimi dhe dizajnimi i identitetit vizual, dizajnit të websitit, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial dhe sinjalistikës/wayfinding për Galerinë Kombëtare të Arteve.			4 muaj	
Faza 1: Konceptimi dhe dizajni bazë Në këtë fazë do të realizohet zhvillimi i konceptit të përgjithshëm të identitetit vizual dhe miratimi paraprak i tij nga Autoriteti Kontraktor.			2 javë	

Konceptimi dhe dizajni bazë	Workshop-i në prezencë ose online. Prezantimi i konceptit të dizajnit për miratim paraprak nga Autoriteti Kontraktor. Pozicionimi institucional, misionit dhe perceptimit publik. Drejtimet kryesore të identitetit vizual: logo, tipografi, ngjyra, gjuhë grafike dhe parime layout-i. Koncepti fillestar për komunikimin digjital dhe sinjalistikën. Harta e faqes web dhe prototip interaktiv ose DEMO	Skedare të hapura / Transferim me link ose në Share point/ Formatet e dorezimeve: PDF/X SVG PNG JPG MP4/MOV OTF/TTF, WOFF/WOFF2 Specifikimet e ngjyrave: CMYK RGB HEX Dorezim i pdf me propozimin / Figma/PDF	Dorëzimi i Fazës 1 do të bëhet 3 javë pasi kontrata është aktive. Operatori Ekonomik do të procedojë me Fazën 2 pas miratimit nga AK të Fazës 1.	34 %
Koha e llogaritur për Komente dhe Aprovim nga AK të Fazës 1		5 ditë		
Faza II – Zhvillimi i dizajnit sistemit të komunikimit Në këtë fazë do të realizohet aplikimi i dizajnit në të gjitha materialet e komunikimit institucional, të printuara dhe digjitale, si dhe materialeve promocionale, si edhe dizajnimi grafik dygjuhësh, harta strukturore, skeleti i faqes web dhe prototipi interaktiv ose DEMO para zhvillimit përfundimtar.		2 muaj		

Zhvillimi i dizajnit të sistemit të komunikimit	Krijim i dizajnit për: - Identiteti vizual institucional - Identiteti administrativ - Sistemi i komunikimit për ekspozitat dhe aktivitetet - Sistemi i komunikimit për koleksionin e përhershëm - Komunikimi digjital / Social Media - Produkte promovionale Dizajnim grafik dygjuhësh Arkitektura e websitit - harta strukturore dhe skeleti i faqes web Dizajn për Desktop dhe Mobile	Skedare të hapura / Transferim me link ose në Share point/ Formatet e dorezimeve: PDF/X SVG PNG JPG MP4/MOV OTF/TTF, WOFF/WOFF2 Specifikimet e ngjyrave: CMYK RGB HEX Figma/PDF Dokument sitemap	Dorëzimi i Fazës 2 do të bëhet 2 muaj pas përfundimit të Fazës 1, Operatori ekonomik do të procedojë me Fazën 3 pas miratimit nga AK të Fazës 2.	20 %
Koha e llogaritur për Komente dhe Aprovim nga AK të Fazës 2			5 ditë	
Faza III – Zhvillimi i dizajnit të sinjalistikës dhe manualit të identitetit vizual Në këtë fazë do të realizohet dizajnimi i sistemit të sinjalistikës dhe orientimit në hapësirë, si dhe hartimi i manualit të plotë të identitetit vizual dhe i rregullave të përdorimit të tij.			2 javë	

Zhvillimi i dizajnit të sinjalistikës dhe manualit të identitetit vizual	Projektimi i sistemit të sinjalistikës së jashtme dhe të brendshme identifikuese, drejtuese dhe informuese . Projektimi i planeve orientuese të kateve dhe planvendosja e elementeve të sinjalistikës Projektimi i etiketave, teksteve murale dhe elementeve të informacionit në hapësirë Prodhimi dhe paraqitja e prototipeve fizike në shkallë 1:1 Specifikimet e materialeve Hartimi i manualit të plotë të identitetit vizual (brandbook)	PDF/X SVG PNG JPG MP4/MOV OTF/TTF, WOFF/WOFF2 CAD/DWG Specifikimet e ngjyrave: CMYK RGB HEX	Dorëzimi i Fazës 3 do të bëhet 1 muaji pas përfundimit të Fazës 2, Operatori ekonomik do të procedojë me Fazën 4 pas miratimit nga AK të Fazës 3.	20 %
Koha e llogaritur për Komente dhe Aprovim nga AK të Fazës 3			4 ditë	
Faza IV – Implementimi i botimeve Në këtë fazë do të realizohet përgatitja teknike e materialeve botuese.			2 javë	
Implementimi i botimeve	Përgatitja teknike e publikimeve për shtyp	Publikim: PDF/X	Dorëzimi i Fazës 4 do të bëhet 1 muaj pas përfundimit të Fazës 3.	26 %
Koha e llogaritur për Komente dhe Aprovim nga AK të Fazës 4			4 ditë	

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Për Lotin 2: **Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.**

Shërbimi duhet të realizohet brenda afatit prej **2 (dy) muajsh**, sipas fazave të përmendura në kapitullin

Pas miratimit të marrë nga autoriteti kontraktor për aprovim të koncepteve, për çdo fazë, operatori ekonomik duhet të dorëzojë produktet përkatëse sipas planit të punës dhe grafikut të realizimit, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor.

Pagesa do të kryhet në mënyrë të pjesshme, sipas fazave të përfundimit dhe pas miratimit të dorëzimeve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor.

DETYRA	PËRMBAJTJA	FORMATI	KOHËZGJATJA E DETYRËS	Planifikimi i pagesave
Loti 2: Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.			2 muaj	
Faza I – Zhvillimi teknik i website, frontend/backend, CMS dhe database Në këtë fazë realizohet programimi i plotë, integrimi frontend/backend, CMS dhe sistemi i të dhënave. Testim, trajnim dhe dorëzim.			2 muaj	

Zhvillimi teknik	Programimi i plotë Responsive design Elemente interaktive Integrim grafikash dhe animacionesh Funksione bazë për aksesueshmëri CMS Integrim frontend/backend Data System / Database Testim në shfletues të ndryshëm Testim në pajisje të ndryshme Testim i aksesueshmërisë Trajnim CMS për stafin Dorëzim final Mirëmbajtje 6 muaj pas lançimit	Kod burimor Github në zotërimin e Galerisë Kombëtare USB ose Cloud Dokumentacion teknik Raport testimi Manual përdorimi Dokumentacion CMS Arkivë e strukturuar e skedarëve	Dorëzimi i Fazës I bëhet pas përfundimit të zhvillimit teknik dhe miratimit nga AK.	100%
Koha e llogaritur për Komentë dhe Aprovim nga AK të Fazës I			5 ditë	

Shënim: Zhvillimi i Lotit 2 do të nisë në momentin e dorëzimit të materialeve nga Autoriteti Përfutues “Galeria Kombëtare e Arteve”.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

TË NJEJTA PËR TE DYJA LOTET

1. QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një sistemi të unifikuar, të qëndrueshëm dhe bashkëkohor të identitetit vizual dhe komunikimit institucional të Galerisë Kombëtare të Arteve.

Ky sistem synon të përmirësojë komunikimin institucional të GKA-së, të rrisë koherencën vizuale të materialeve të institucionit dhe të mbështesë prezantimin publik të programit të ekspozitave, koleksionit dhe aktiviteteve të tjera të institucionit.

Gjithashtu projekti përfshin komunikimin dhe sinjalistikën në lidhje me godinen dhe programin artistik në abjentet e reja të Galerisë Kombëtare të Arteve.

Sistemi duhet të mundësojë integrimin e komunikimit fizik dhe digjital dhe të jetë i përshtatshëm për përdorim afatgjatë nga stafi i institucionit.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka kontraktuar në vitin 2021 projektin “Restaurimi, rikonstruksioni dhe rehabilitimi i hapësirave në Galerinë Kombëtare të Arteve”. Galeria Kombëtare e Arteve po përgatitet për rihapjen e saj në vitin 2026, me standarde të reja institucionale dhe me qëllimin për të përmirësuar menaxhimin institucional, programacionin artistik dhe një qasje sa më atraktive ndaj një publiku gjithnjë në rritje. Ky standard i ri i GKA-së synon ta pozicionojë Galerinë Kombëtare në rrjetin e institucioneve të ngjashme evropiane. Për këtë arsye, identiteti vizual dhe mënyra se si institucioni komunikon me publikun duhet të jenë në përputhje me standardet bashkëkohore të institucioneve homologe në rajon dhe në Evropë.

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike të lotit përkatës.

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike të lotit përkatës

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Galeria Kombëtare e Arteve

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Loti 1: Konceptimi dhe dizajnimi i identitetit vizual, dizajnit të websitit, sistemit të komunikimit institucional, dizajnit editorial dhe sinjalistikës/wayfinding për Galerinë Kombëtare të Arteve.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion të paktën:

a) 1 (një) Menaxher Projekti/ Drejtor Kreativ dhe Artistik

- c) të ketë përfunduar arsimin e lartë në dizajn, komunikim vizual, arte pamore ose fusha të ngjashme;

b) 1 (një) Dizajner Grafik/Artistik

- të ketë përfunduar arsimin e lartë në dizajn grafik, komunikim vizual, arte pamore, multimedia ose fusha të ngjashme;

Për secilin anëtar të stafit duhet të paraqiten:

- Diploma;
- Kontrata e punës e vlefshme.
- CV

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Loti 2: Zhvillimi teknik (programim) i platformës website, CMS dhe implementimi teknik i komunikimit digjital për Galerinë Kombëtare të Arteve.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë:

Certifikatë të vlefshme SSH EN ISO/IEC 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, me objekt certifikimi në përputhje me natyrën e shërbimeve objekt prokurimi.

